

REZOLUTË

- Në respekt të mbështetjes së shumicës dërrmuese të shqiptarëve për anëtarësim të plotë dhe të merituar të Shqipërisë në Bashkimin European;

- Me mirënjohje për mbështetjen që Bashkimi European i ka dhënë Shqipërisë gjatë gjithë këtyre viteve, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës, parimeve të demokracisë dhe ndërtimit të një ekonomie tregu funksionale;

- Duke marrë në konsideratë progresin e bërë nga Shqipëria në procesin e integritimit në Bashkimin European, reflektuar në zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- Duke marrë në konsideratë vlerësimin mbi progresin e arritur nga Shqipëria, në përmbushje të 12-të prioriteteve të përcaktuara në Opinionin e Komisionit European;

- Duke marrë në konsideratë faktin se zhvillimi i zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013, i vlerësuar në raportin e OSBE/ODIHR-it dhe në Raportin e Progresit 2013 të Komisionit European, përbën një sukses të qenësishëm për Shqipërinë;

- Duke mbështetur dhe vlerësuar si një nxitje për vijimin e reformave, propozimin pa kushte të Komisionit European për dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë;

- Duke marrë në konsideratë faktin që dialogu politik i realizuar nëpërmjet, gjithëpërfshirjes dhe transparencës, është kusht kryesor për progresin e Shqipërisë në procesin e integritimit european;

- Duke riafirmuar që integrimi në Bashkimin European, është agjenda kombëtare dhe qëllimi strategjik i Shqipërisë, si një vend që synon konsolidimin e demokracisë, respektimin e shtetit të së drejtës, garantimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura, forcimin e një ekonomie tregu funksionale, garantimin dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe minoriteteve, që përbëjnë edhe vlerat kryesore mbi të cilat është themeluar Bashkimi European;

- Duke qenë të vetëdijshëm për rolin e Kuvendit, si shprehje e vullnetit të popullit, në procesin e integritimit european, përfshirë rolin kontrollues të Kuvendit, të domosdoshëm në procesin e integritimit european, nën frymën e bashkëpunimit konstruktiv midis mazhorancës dhe opozitës parlamentare;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

1. Rikonfirmon se integrimi i Shqipërisë në BE është objektivi madhor i vendit dhe përbën agjendën tonë kombëtare.

2. Vlerëson rekomandimin e Komisionit European për dhënien e statusit të vendit kandidat për Republikën e Shqipërisë.

3. Konfirmon qasjen e tij, që përparimi në procesin e integritimit european të Shqipërisë, bazohet në meritë, në përputhje me reformat dhe arritjet konkrete.

4. Vlerëson mbështetjen që Bashkimi European ka dhënë për Shqipërinë gjatë gjithë këtyre viteve, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe parimeve të demokracisë funksionale.

5. Thekson se marrja e statusit të vendit kandidat brenda dhjetorit të këtij viti, duhet të përbëjë prioritetin kryesor të punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Qeverisë.

6. Mbështet Dialogun e Nivelit të Lartë BE-Shqipëri me një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse me fokus përmbushjen e 5 prioriteteve kyçe të identifikuara nga Raporti i Progresit për hapjen e bisedimeve për anëtarësim.

7. I kërkon Qeverisë të konsolidojë reformat e arritura që qëndrojnë në themel të propozimit të Komisionit European për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe t'i avancojë ato, si dhe të thellojë më tej përpjekjet për integrimin në familjen europiane, duke prezantuar një agjendë të qartë/plan veprimi kryesisht me fokus përmbushjen e 5 prioriteteve të Komisionit European, të riformuluara në Progres Raportin e fundit, si dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në një proces gjithëpërfshirës dhe të përshpejtojë procesin e çeljes së bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin European.

8. I kërkon Qeverisë të angazhohet për marrjen e të gjitha masave për forcimin e shtetit të së drejtës dhe parimeve të demokracisë funksionale, veçanërisht për:

a) mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

b) ekzekutimin e vendimeve të gjykatave;

c) mbrojtjen e garancive kushtetuese të nëpunësve të administratës publike;

ç) konsolidimin dhe mbrojtjen e autonomisë lokale;

d) luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit;

dh) mbrojtjen e lirisë ekonomike dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit; si dhe

e) garantimin e një bashkëpunimi konstruktiv midis mazhorancës dhe opozitës parlamentare.

9. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, si: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, Policia e Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, INSTAT-i, Autoriteti i Mediave Audiovizive etj. dhe i kërkon Qeverisë të bëjë të njëjtën gjë.

10. Angazhohet të shqyrtojë me prioritet dhe në një proces të gjerë konsultimi, kuadrin ligjor që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës reformuese të integritetit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën dhe *acquis* e Bashkimit European.

11. Thekson rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin integruar të vendit, duke u bërë pjesë integrale, kryesisht në përmbushjen e 5 prioritetëve të caktuara nga Komisioni European në Progres Raportin 2013.

12. Unanimisht u kërkon vendeve anëtare të Bashkimit European që të mbështesin propozimin e Komisionit European për dhënien e statusit kandidat për Shqipërinë, si dhe të ardhmen europiane të vendit tonë.

Miraturar në datën 27.11.2013